**Titulli i aktivitetit**

Gjeje gjethin

**Mosha**

Periudha zhvillimore 4 -6 vjeç

| **Hapësira / lokacioni** | **Vlera e karakterit** |
|---|---|
| Kushte shtëpie | Percepcion |
| **Koha e nevojshme për përgatitje** | **Koha e nevojshme për realizim** |
| 30 minuta | 20-25 minuta |

**Qëllimet**

Qëllimi është që tek fëmija të zhvillohet percepcion i fokusuar.

**Rezultatet e pritshme**

Fëmija krahason dhe gjen gjethe të njëjta.

**Kahje**

**<u>Përgatitje paraprake për aktivitet</u>**

Dilni për shëtitje në natyrë me fëmijën dhe mblidhni dy gjethe të njëjta nga pemë të ndryshme. Pastaj vendosini ndërmjet fletëve të gazetave dhe vendosni diçka të rëndë mbi to. Duhet të rrinë ashtu disa orë që të shtypen. Pastaj priten kartela kartoni, aq sa ka gjethe të shtypura.

**<u>Instrukcione/kahje për lojën</u>**

Fëmijës i shpjegohet se çdo gjeth duhet të ngjitet në kartelë të veçantë dhe të ndahen kartelat ndërmjet dy pjesëmarrësve në lojë, kështu që çdo lojtar duhet të ketë nga një gjeth të ndryshëm nga secili çift gjethesh të njëjta (shtesa nr. 1).

**<u>Aktivitet/lojë</u>**

Bisedoni me fëmijën sipas kujtesës për shëtitjen dhe gjethet e ndryshme. Mund t'i emërtoni, t'i përshkruani dhe t'i dalloni kartelat. Pastaj ndani kartelat sipas instrukcioneve të dhëna dhe luajeni lojën, kështu që njëri lojtar tregon një kartelë me një gjeth, ndërsa lojtari tjetër duhet ta gjejë kartelën me gjethin e njëjtë nga kartelat e veta dhe t'i vënë në çift. Dëftimi i

<table>
<tr><td colspan="2">kartelave bëhet me radhë ndërmjet dy lojtarëve. Loja mbaron kur të çiftëzohen të gjitha kartelat. Në fund, propozojuni fëmijëve të bëjnë një herbarium nga bimë të ndryshme që do t’i mbledhin dhe do t’i shtypin pas shëtitjeve të radhës (shtesa nr. 2).</td></tr>
<tr><th>Прилози</th><th>Materiale</th></tr>
<tr><td><u>Shtesa nr. 1</u><br><br>Fotografi nga aktiviteti<br><br><br><u>Shtesa nr. 2</u><br><br>Fotografi nga realizimi<br></td><td><ul><li>Gjethe</li><li>Karton</li><li>Gërshërë</li><li>Ngjitës</li></ul></td></tr>
</table>



**Aktiviteti është përgatitur nga:**

Edukatorë: Sonja Çallovska, Vesna Peceva

Dizajn grafik: Katerina NIkollovska

Lekturë: Jana Mihajllovska

Përkthim: Agim Leka